



Nr. 3652 prot

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KRYETARI

VENDIM

Nr. 201, Datë 31.03.2023

“PËR

**NDËRMARRJEN E NISMËS PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTIT TË  
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR, BASHKIA LEZHË ME PROCEDURË TË  
THJESHTUAR”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, në nenin 13, pika 1, shkronja “b”, në nenin 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, në nenin 11 dhe 12 të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, e ndryshuar, Kryetari i Bashkisë,

**VENDOSI:**

1. Të ndërmarrë nismën për rishikimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të thjeshtuar, për ato çështje dhe kërkesa të cilat:
  - a. Janë në perputhje dhe nuk bien në kundërshtim me legjislacionin sektorial në fushën e mjedisit, zonave te mbrojtura, trashegimine historike e kulturore;
  - b. Janë në përputhje, nuk bien në kundërshtim dhe nuk ndryshojne dokumentin e Strategjisë Territoriale;
  - c. Vijnë si pasojë e konstatimit të gabimeve e mosperputhjeve në dokumentin e Planit dhe mes pjesëve përbërëse të tij, si edhe mes Planit e gjendjes faktike në territor;
  - d. Vijnë si pasojë e forcave madhore, si: tërmete, përmbytje, zjarre masive, rrëshqitje të tokës, erozion, etj., të ngashme, për shkak të ndarjeve administrative e territoriale, ndryshimeve te paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshimeve të shkaktuara nga kriza sektoriale;
  - e. Vijnë si nevoje për harmonizimin me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe per arsyen e përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

2. Pjesë integrale e këtij vendimi është dokumenti i nismës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban pranë Bashkisë Lezhë.
4. Vendimi për miratimin e Nismës dhe dokumenti i Nismës botohen në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e miratimit.

**K R Y E T A R I**

**Z. Pjerin NDREU**

